



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA

AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/

AGENCY OF GENDER EQUALITY

**Plani i Veprimit në zbatim të Rezolutës 1325,
“Gratë, Paqja dhe Siguria”
2013-2015**

Mars 2014

E drejta autoriale është e drejtë ekskluzive e Agjencisë për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeminsitrit.
Plani i Veprimit në zbatim të Rezolutës 1325, “Gratë, Paqja dhe Siguria” 2013- 2015
Për cdo interpretim të këtij dokumenti verzioni në gjuhën shqipe është dominues.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 ZYRA E KRYEMINISTRIT/OFFICE OF THE PRIME MINISTER/URED PREMIJERA
 Agjencia për Barazi Gjinore/ Agencija za Ravnopravnost Polova/ Agency for Gender Equality

Prishtinë, Shkurt 2014

Të nderuar/a,

Agjencia për Barazi Gjinore ne kuadër te Zyës së Kryeministrit, e cila eshte e mandatur te harojë politika publike për përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha sferat e jetës publike, në bashkëpunim me Grupin e Punës të themeluar me 20 Shkurt 2012, ka hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 ne Republikën e Kosovës.

Procesi i hartimit te këtij dokumenti strategjik është realizuar përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe te bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Barazi Gjinore, Rezolutën 1325, si dhe dokumentet strategjike të miratuara nga Qeveria e Republikës se Kosoves, si Programi i Kosovës për Barazi Gjinore, Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014, dhe Strategjia Antitrafikim.

Rezoluta 1325 "Gratë, Paqja, dhe Siguria" e Këshillit te Sigurimit të Kombeve te Bashkuara, riafirmon rolin që gratë luajnë në ndërtim të paqes dhe sigurisë, dhe shënon rastin e parë kur Këshilli i Sigurimit adreson ndikimin jo-proporcional dhe unik që konfliktet e armatosura kanë mbi gratë, si dhe domosdoshmërinë e angazhimit të gruas në procesin e rindërtimit të shtetit dhe stabilitetit. Zbatimi i kësaj Rezolute nënkupton ngritje të nivelit të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, procese paqësore, si dhe fuqizim të mekanizmave mbrojtës dhe inkoorporim të dispozitave të barazisë gjinore në të gjitha strukturat.

Hartimi dhe miratimi i Planit te Veprimit per zbatim te Rezolutes 1325 "Grate, Paqja, dhe Siguria", ne kontekstin e Kosovës rritetson gadishmërinë e institucioneve per te siguruar edhe me tutje pjesëmarrjen e plotë të grave në të gjitha aspektet e paqeruajtjes -nga negociatat e deri te rindërtimi i pas luftës, adresimin e çështjes së viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, si dhe integrimin e çështjeve gjinore ne sektorin e sigurisë dhe përfaqësimit e barabartë të gruas në misionet jashtë vendit, dhe bashkëpunimin e ngushtë të institucioneve me organizatat e grave.

Një falënderim i veçantë i dedikohet Grupit Punues të këtij dokumenti strategjik, shoqërisë civile, si dhe partnerëve tanë nderkombëtar, Zyra e Komisarariatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut ne Kosovë, dhe Agjencisë së Kombeve të Bashkuara ne Kosovë -UNWomen, për angazhimin dhe gatishmërinë e tyre për të përkrahur Agjencinë për Barazi Gjinore ne realizimin e mandatit te saj.

Në emër të Agjencisë për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dëshiroj të shpreh vendosshmërinë tonë për të punuar edhe më tutje drejt përmbushjes së vizionit dhe idealit per një barazi dhe një mirëqenie të mirëfilltë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Singerisht,

Edona Hajrullahu

Kryeshefe Ekzekutive

Agjencia për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeministrit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/168

Datë: 29.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 në Republikën e Kosovës.
2. Obligohen Institucionet e përfshira në Planin e Veprimit për zbatimin e tij.
3. Obligohet Agjencia për Barazi Gjinore të themelojë dhe udhëheq me Sekretariatin Ndërinstitucional për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSO QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOS	
Nr. Prot. 01	Nr. Prot. 560
Nr. Prot. 1	Data 20.02.12
Nr. Prot. 1	

Dt. 20.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 4.1 dhe 7 paragrafi 1.6 të Rregullores nr 02/2011, Zëvendës-Kryeministria e Kosovës, nxjerr këtë

VENDIM

I. Agjencia për Barazi Gjinore udhëheq dhe koordinon Grupin Punues për hartimit e Planin e Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria".

II. Caktohet Grupi Punues në këtë përbërje:

1. Edona Hajrullahu	KE- ABGJ	Kryesuese
2. Leonora Selmani	ABGJ	anëtar/e
3. Violeta Kurti Islami	ABGJ	anëtar/e
4. Edi Gusia	ABGJ	anëtar/e
5. Naser Ajeti	ABGJ	anëtar/e
6. Ariana Qosaj	Presidenca e Kosovës	anëtar/e
7. Besim Kajtazi	ZSHNJ-ZKM	anëtar/e
8. Hysni Shala	PK	anëtar/e
9. Tahire Haxholli	PK	anëtar/e
10. Florentina Beqiraj	MD	anëtar/e
11. Shenaj Berisha	MD	anëtar/e
12. Selman Imeri	MPB	anëtar/e
13. Lirije Maksutaj	MPMS	anëtar/e
14. Shyqeri Hyseni	MF	anëtar/e
15. Hadije Binaku	FSK	anëtar/e
16. Igballe Rogova	RRKG	anëtar/e
17. Flora Macula	UNWOMEN	anëtar/e
18. Besim Kelmendi	Prokuroria Speciale	anëtar/e
19. Jetish Maloku	Prokuroria e Qarkut	anëtar/e
20. Rame Hyseni	Gjykata e Qarkut	anëtar/e
21. Vjosa Nimani- Zylfiu	Gjykata Supreme	anëtar/e
22. Freskina Isufaj	Këshilli Kombetar i Sigurisë	anëtar/e
23. Veprorë Shehu	Medika -Gjakova	anëtar/e
24. Feride Rushiti	QKRMT	anëtar/e
25. Luljeta Vuniqi	QKSGJ	anëtar/e
26. Arbena Kuriu	OHCHR	anëtar/e
27. Suzana Krasniqi	MPJ	anëtar/e
28. Merita Jonuzi	MASHT	anëtar/e

III. Grupi punues është përgjegjës për përgatitjen e draftit përfundimtar të Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 "Gruaja, Paqja dhe Siguria".

IV. Agjencia për Barazi Gjinore monitoron zbatimin e Planit të Veprimit të Rezolutës 1325 "Gruaja, Paqja dhe Siguria".

V. Vendimi hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit.

Zëvendëskryeministër e Republikës së Kosovës

Mimoza Kusari-Lila

Vendimi i dërgohet:

- Të gjithë anëtarëve;
- Agjencisë për Barazi gjinore
- Arkivit të Qeverisë.

Lista e shkurtimeve

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AP	Avokati i Popullit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DASHC	Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
KS	Këshilli i Sigurimit
GP	Grupi i punës
GKSGJ	Grupi për Koordinim të Sigurisë dhe Gjinisë
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
LBGJ	Ligji për barazi gjinore
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MAP	Ministria e Administratës Publike
MBZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NJDV	Njësitë e te drejtave te njeriut
OJQ	Organizatat Jo Qeveritare
OSBE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PNV (PV)	Plani Nacional i Veprimit (Plani i Veprimit)
RZhNjK	Raporti zhvillimit njerëzor të Kosovës
RAE	Roma, Ashkali, Egjyptian
RrGGK	Rrjeti i Grupimit të Grave të Kosovës RVL
Lobi	Rajonal i grave për Paqen dhe Sigurinë
TQNj	Trafikimi me Qenie Njerëzore
ZKM	Zyra e Kryeministrit
UNDP	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNWOMEN	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave
OHCHR	Komisariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
NATO	North Atlantic Treaty Organization
OSBE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë

Përmbajtja**PARATHENIE**

Parimet mbi të cilat mbështetet hartimi i PV-së.	7
Parimi i transparencës dhe gjithëpërfshirjes	7
Parimi i pronësise vendore.....	7
Parimi i vazhdimsisë	7
Nje dokument dinamik dhe real	8
Qasja tek të drejtat e njeriut	8
Qasja ndërsektoriale	8

SFONDI	9
Kosova.....	9
Gratë, Paqja dhe Siguria	9
Rezoluta e Keshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 mbi Grate Paqen dhe Sigurine dhe Konventa e eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit ndja grave	9
Grate, Paqja dhe Siguria në Kosovë	

II. ANALIZA E SITUATËS 13

II.1 Kosova dhe perspektiva e zhvillimit njerzor	13
II.1.1 Veçoritë demografike dhe Indeksi i zhvillimit njerzor në Kosovë	13
II.1.2 Gratë si faktor i ndryshimit	13
II.1.3 Përfaqsimi politik dhe pjesmarja e grave në vendimarrje.....	13
II.1.4 Përfaqsimi i grave në ekzekutiv	14
II.1.5 Partite politike	15
II.1.6 Administrata publike	16
II.1.7 Pjesmarja e grave në diplomaci.....	16
II.2.1 Pjesmarja e grave në sistemin gjyqësor.....	17
II.2.2 Perspektiva gjinore në sektorin e sigurisë	18
II.2.3 Dhuna me baze gjinore	19
II.2.4 Grate viktime të luftës	21

III. VLERËSIMI I MEKANIZMAVE LIGJOR DHE INSTITUCIONAL..... 23

III.1 Kuadri ligjor ekzistues dhe politikat	23
III.1.1 Dokumentet ligjore vendore që rregullojnë aspekte të ndryshme të Rezolutes 1325	23
III.1.2 Politikat, strategjitë dhe planet e veprimit	25
III.1.2 Dokumentat ligjore ndërkombëtare	27
III.2 Mekanizmat institucional	29
III.2.1 Institucionet vendore	29
III.2.2 Institucionet ndërkombëtare	31
III.2.3 Shoqëria Civile avokuese e Rezolutës 1325	32

VI. PLANI I VEPRIMIT NE ZBATIM TE REZOLUTES 1325 100

Parathënie

Në 20 Shkurt 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës² mori vendimin për hartimin e Planit të Veprimit në zbatim të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria”. Vendimi obligoi Agjencinë për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit, të koordinojë dhe të udhëheqë grupin punues për hartim të Planit të Veprimit, të përbërë nga përfaqësues të institucioneve, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtar. Agjencia për Barazi Gjinore ka mandat të zbatojë dhe të monitorojë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, dhe njëkohësisht të hartojë politika publike që promovojnë vlera dhe mundësi të barabarta pa marrë parasysh përkatësinë gjinore. Në këtë proces të hartimit të planit të veprimit, Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), edhe Zyra e Komisarariatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) kanë dhënë ndihmën e tyre për realizimin e një procesi korrekt, si dhe kanë kontribuar me ekspertizën e tyre si anëtarë të grupit punues.

Plani i Veprimit do të sigurojë:

- promovimin dhe zbatimin e Rezolutës së KB 1325 në Kosovë;
- nëpërmjet masave dhe veprimeve që do të parashikohen në PV, Kosova të kontribuojë në zbatimin e Rezolutës 1325 në nivel lokal, rajonal dhe global
- një mundësi për të koordinuar veprimet e përbashkëta të shtetit, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit për të zbatuar Rezolutën 1325 dhe programet e tjera që promovojnë çështjen gjinore në Kosovë .
- krijimin e një premisë të re për fuqizimin dhe promovimin e të drejtave njerëzore të grave
- integrimin e çështjeve gjinore në sektorin e sigurisë
- krijon mundësi për të promovuar “të drejtën tranzicionale” në Kosovë.
- plani do të hapë rrugën për shkëmbimin e eksperiencave që vende të ndryshme kanë në zbatimin e Rezolutës, për kontributin e grave në çështje të paqes dhe sigurisë.
- fokuson vëmendjen e shoqërisë dhe angazhimin e institucioneve për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të konfliktit të armatosur në Kosovë
- Plani bën të mundur që nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta si, debate publike, fushata sensibili lizuese, tryeza të rrumbullakëta dhe forma të tjera të informimit të publikut, të promovojë Rezolutën 1325 në Kosovë.

Ky është një plan strategjik afatmesëm, koha gjatë së cilës do të realizohen objektivat dhe aktivitetet në kuadër të këtij plani shtrihet në tre vjet.

²Vendimi i marrë nga – zv. Kryeministria e Kosovës, znj. Mimoza Kusari-Lila.
Vendimi nr.560 datë 20/02/2012 (shih Aneksi 1.)

Parimet mbi të cilat mbështetet hartimi i PV-së.

Parimet e mëposhtme kanë qëndruar në thelb të hartimit të Planit, dhe do të ndjekin edhe zbatimin e tij.

Parimi i transparencës dhe gjithëpërfshirës

Synimi për të hartuar një dokument politikash të pranuar gjerësisht nga të gjithë aktet e përfshirë, kërkon zhvillimin e një procesi të hapur, transparent dhe gjithëpërfshirës. Zbatimi i këtij parimi, është sanksionuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të themeluar një strukturë me 28 anëtare (Grupi Punues) e cila është gjerësisht përfaqësuese³. Qasja shume sektoriale dhe gjithëpërfshirja është siguruar nga pjesëmarrja e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës me zyrtare të nivelit të lartë, pjesëmarrja e institucioneve të gjyqësorit, dhe përfaqësues të shoqërisë civile të cilët gjatë procesit të hartimit të planit kanë bashkëpunuar dhe janë mbështetur nga organizatat ndërkombëtare UN Women dhe OHCHR. Veç kësaj, vetë procesi i hartimit të Planit ka siguruar transparencën nëpërmjet përfshirjes së medias dhe grupeve të ndryshme të interesit. Pjesëmarrësit në proces nuk kanë ofruar vetëm ekspertizën e sektorëve të ndryshëm, por edhe zërin e grupeve të interesave të veçanta.

Parimi i pronësisë vendore

Dokumenti i PV-së për zbatimin e Rezolutës 1325, ka pronësi vendore; kjo materializohet në konceptimin e objektivave dhe aktiviteteve që janë parashikuar në këtë plan, si edhe në burimet⁴ materiale, financiare dhe njerëzore që do të përdoren për realizimin e këtyre objektivave. Konkretisht, gjatë kostimit të masave dhe aktiviteteve janë patur parasysh, buxhetet vendore përkatësisht ato të vitit 2013, buxheti afatmesëm i Kosovës dhe Plani i ndihmës nga donatorët. Përgjegjësitë për zbatimin e PV R 1325 qëndrojnë tek institucionet e Qeverisë së Kosovës⁵. Kjo është sanksionuar edhe në Vendimin përkatës, ku ABGJ përcaktohet si institucioni përgjegjës për koordinimin e punës për implementimin e këtij Plani. Plani do të jetë një mekanizëm për të ngritur fonde dhe rritur angazhimin e donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtar për promovimin e çështjes së grave, paqes dhe sigurisë në Kosovë.

Parimi i vazhdimësisë

PV për zbatimin e Rezolutës 1325, do të mbështetet në identifikimin dhe analizën e angazhimeve dhe aksioneve ekzistuese të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës, shoqëria civile dhe palët e interesit dhe që kanë prerje (lidhje) me Rezolutën 1325. Analiza do të shërbejë për të sjellë në vëmendje të të gjitha çështjet kritike që kanë të bëjnë me gratë, paqen dhe sigurinë.

³ Grupi i punës përbehet nga përfaqësues të institucioneve qeveritare të cilat lidhen me çështjen e paqes dhe sigurisë, përfaqësues të shoqërisë civile me kontribut në këtë fushë, si dhe përfaqësues të partnerëve ndërkombëtar të cilët do të kenë një rol kontribuues dhe mbështetës në këtë proces.

⁴ Gjatë kostimit të masave dhe aktiviteteve janë patur parasysh, buxhetet vendore përkatësisht ato të vitit 2013, buxheti afatmesëm i Kosovës dhe Plani i ndihmës se huaj (shënim i draftuesit)

⁵ ABGJ është përcaktuar si institucioni përgjegjës për monitorimin e implementimit të PV, me Vendimin e zv. Kryeministrit të Kosovës, znj. Mimoza Kusari-Lila, nr.560 datë 20/02/2012 (shih Aneksi 1.)

Një dokument dinamik dhe real

PV R 1325, do të jetë një dokument i gjallë dhe dinamik, i cili mund të adaptohet në përputhje me ndryshimet në kontekstin ekonomik dhe social të vendit. Ndryshimet do të jenë rezultat i mësimave të mësuara dhe sfidave që dalin përpara gjatë procesit të zbatimit, të paraqitura në raportet e monitorimit dhe vlerësimit. Rekomandimet që do të jepen në këto raporte do të shërbejnë për të iniciuar ndryshimet e nevojshme në dokument. PV do të buxhetohet bazuar në buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të Kosovës si dhe planin e ndihmës nga donatorët në Kosovë dhe jashtë Kosovës. PV do të mbajë në konsideratë prioritetet që do të vendosen gjatë diskutimeve në grupet e punës. Buxheti i këtij plani është bërë duke marrë në konsideratë Planin Financiar Afatmesëm, buxhetin vjetor të Kosovës si dhe buxhetet e angazhuara nga donatorët në programe të ndryshme.

Qasja tek të drejtat e njeriut

PV R 1325, do të ketë një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, dhe do të promovojë në veçanti mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave, gratë në vendim marrje dhe mbështetjen që Qeveria do ti japë qytetarëve të Kosovës, veçanërisht grave dhe burrave viktimë të luftës.

Qasja ndërsektoriale

Dokumenti do të synojë të koordinojë veprimet dhe aktivitetet në sektorin publik dhe jo publik, siç janë: Institucioni i Avokatit të Popullit, Policia, Prokuroria dhe Gjykatat, Ministria e Brendshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, media, shoqëria civile etj, si dhe do të bashkërendojë veprimet me dokumentet e tjerë strategjik dhe palët e interesit që veprojnë në këtë fushë.

Sfondi

Kosova

Deri në vitin 1999, në Kosovë ka ekzistuar shteti komunist dhe më vonë ai policor, i cili ishte institucioni i vetëm që komandonte jetën politike, ekonomike dhe sociale të vendit duke shmangur funksionet institucioneve demokratike të vendimmarrjes dhe ato të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në këtë mënyrë shteti mbetej arbitri kryesor dhe dominant në përcaktimin e normave dhe vlerave duke përfshirë edhe ato të paqes dhe sigurisë. Për më tepër, gratë, si gjatë dhe pas luftës, ashtu edhe gjatë tranzicionit, u ndodhën në një mjedis social dhe ekonomik ku kushtet për barazi dhe siguri, ndryshuan. Nga njëra anë, mund të themi se u shtuan mundësitë për avancimin e grave, por nga ana tjetër u shtuan pasiguria dhe rreziqet për to.

Kosova deklaroi pavarësinë me 17 Shkurt 2008. Deklarata e pavarësisë erdhi pasi Kosova siguroi mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe SHBA për shpalljen e Kosovës shtet me vete dhe të pavarur. Megjithatë pavarësia u kundërshtua nga Serbia, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë, vendosi se deklarata ishte konform ligjeve ndërkombëtare. Bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë filluan me 8 Mars të 2011, me BE në rolin e ndërmjetësuesit. Që nga shpallja e pavarësisë dhe krijimi i Qeverisë, Kosova ka bërë përpjekje të suksesshme në fushën e ndërtimit dhe stabilizimit, konsolidimit të institucioneve shtetërore demokratike. Ka bërë përpjekje të suksesshme në fushën e ndërtimit dhe të konsolidimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës, që janë dy sektorët më mirë të organizuar në Kosovë. Megjithatë, vendi përballë sfidat e zhvillimit ekonomik dhe social, të orientuara drejt integritetit në familjen Evropiane. Ka një agjendë politikash që tregon për angazhimin e Qeverisë për promovimin e të drejtave të njeriut, e cila stimulohet fuqishëm edhe nga shoqëria civile e mbështetur nga organizatat ndërkombëtare prezentë në Kosovë.

Gratë, Paqja dhe Siguria

[Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 mbi Gratë Paqen dhe Sigurinë dhe Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave CEDAW.](#)

Grupet e grave, kanë luajtur një rol vendimtar për të bindur Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të adoptuar Rezolutën 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

1325 është Rezoluta e parë e Këshillit të Sigurimit që lidh përvojat e grave me konfliktet dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Kjo rezolute potencon lidhshërinë e grave dhe rolin e tyre në zgjidhjen e konflikteve gjatë bisedimeve për paqe dhe rimëkëmbje, kërkon përfshirjen e reagimit me ndjeshmëri gjinore në misionet paqeruajtëse si dhe trajnime për barazi gjinore për të gjithë ata që janë përfshirë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë⁶.

Me anë të Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria", Këshilli i Sigurimit sjell në vëmendje të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, integritetin e perspektivës gjinore në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes si dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna me bazë gjinore. Rezoluta kërkon gjithashtu angazhimin e shteteve për të dhënë fund pa-ndëshkueshmërisë së përgjegjësve për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, përfshirë këtu edhe ato që janë të lidhura me dhunën seksuale dhe llojet e tjera të dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Rezoluta 1325 revokon dhe bazohet në një sërë rezolutash, dokumentesh dhe angazhimesh të OKB-së për çështjen e barazisë gjinore dhe respektimin e të drejtave të grave. Në vitin 2008 Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1820, e cila e adreson dhunën seksuale në situata të konfliktit dhe post-konflikt. 1820 është Rezoluta e parë e Këshillit të Sigurimit e cila njeh dhunën seksuale të ndërlidhur me konfliktin, si taktikë lufte dhe çështje problematike për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së në vitin 2004 në raportin mbi implementimin e Rezolutës, i bëri thirrje vendeve, për hartimin e planeve nacionalë të veprimit në zbatim të Rezolutës 1325. Që atëherë OKB-ja ka hartuar një agjendë mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, e cila u ndoq nga disa rezoluta të tjera radhazi siç janë ato: 1820, 1888, 1889 dhe 1960⁷. Në vitin 2009, Këshilli i Sigurimit e konstatoi se progresi në implementimin e Rezolutave 1325 dhe 1820 ishte i ngadalshëm dhe miratoi dy rezoluta tjera: 1888 dhe 1889. Rezoluta 1888, përforcon mënyrat/mjetet për zbatimin e rezolutës 1820 përmes emërimit të një lidhshërie të nivelit të lartë, ndërtimit të ekspertizës për përgjegjshmëri juridike, përfshirjen e shërbimeve, dhe ndërtimit të mekanizmave raportuese.

⁶ http://www.unwomen.org/wp-content/uploads/2011/10/UNSC-resolutions-on-women-peace-and-security_Poster_English.pdf

⁷ Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 (2000), UNSCR 1820 (2008), UNSCR 1888 (2009), UNSCR 1889 (2009) and UNSCR 1960 (2010) <http://www.un.org/documents/scres.htm>

Rezoluta 1889 merret me mospërfshirjen e grave në fazat fillestare të rimëkëmbjes dhe ndërtimit të paqes si dhe mungesës së planifikimit adekuat dhe financimit për nevojat e tyre. Kërkon përpilimin e strategjisë për rritje të përfaqësimit të grave në procesin e vendimarrjes për zgjidhje të konflikteve dhe kërkon krijim e mjeteve për përmirësimin e zbatimit të: indikatorëve dhe propozimeve për mekanizma monitorues. Kurse rezoluta 1960 (2010), Siguron sistemin e llogaridhënies për adresimin e dhunës seksuale të ndërlidhur me konfliktet, përfshirë mënyrat e publikimit të emrave të keqbërësve dhe themelimit të mekanizmave për monitorim, analizë dhe raportim⁸.

Në këtë kuadër, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe disa organizata të shoqërisë civile në Kosovë janë angazhuar për zbatimin e Rezolutës 1325 duke shprehur vullnetin për hartimin e Planit të Veprimit (PV)⁹. Por, përpara se PV të hyjë në procesin e diskutimeve dhe të hartimit të tij, është e domosdoshme të sjellim në vëmendje çfarë është bërë në Kosovë deri tani lidhur me integrimin e perspektivës gjinore në vendimarrje, rolin e grave në zgjidhjen e konfliktit dhe ruajtjen e paqes, dhe ndëshkimin e atyre që shkaktojnë krime gjatë luftës.

Është tej mase e rëndësishme që fillimisht të njohim situatën në të cilën ndodhemi, të njohim e të analizojmë hendeqet dhe arsyet që kemi në planin politik ekonomik e social si dhe vullnetin dhe burimet e shoqërisë për t'u angazhuar në zbatim të kësaj rezolute. Ky raport mbështetet në një numër të konsiderueshëm dokumentesh (rreth 30), ndër të cilat; legjislati i relevant dhe përmirësimet e bëra në kuadrin ligjor, raporte të monitorimit të të drejtave të njeriut hartuar nga institucionet ndërkombëtare, hulumtimet e bëra nga institucionet dhe gjithashtu shoqëria civile (RrGGK në vitet 2007 dhe 2009), si dhe në një sërë dokumentesh të tjerë studimore të vlerësimit dhe monitorimit të çështjeve që kanë të bëjnë me këtë Rezolutë. Raporti analizon të dhënat administrative dhe informacionin statistikor të ofruar nga institucionet e Kosovës siç janë, ABGJ, ASK, MEF, MPB, MD, MSHP/DASHC, mbi tregues sinjifikativ që tregojnë për situatën politike, ekonomike dhe sociale të grave dhe burave në Kosovë. Gjithashtu, analiza është mbështetur në dy raportet e monitorimit të R 1325 të viteve 2009 dhe 2007 të kryera nga RrGGK si dhe në hulumtimet e kryera nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare¹⁰. Të dhënat, për disa tregues që i kemi përzgjedhur për të bërë këtë analizë, do të vendosin pikat për hartimin e Planit të Veprimit në zbatim të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria", për periudhën 2013-2015.

Në kapitullin e dytë të këtij raporti, analizohet pozicioni i gruas nga perspektiva e zhvillimit njerëzor, duke peshuar treguesit e zhvillimit ekonomik, dhe treguesit e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe ato të mirëqenies sociale. Gjithashtu në këtë kapitull analizohet roli i grave si faktor i ndryshimit (pjesëmarrja në vendimarrje dhe politikë-bërje). Në kapitullin e tretë, bëhet një analizë e kuadrit ligjor dhe mekanizmave institucional brenda dhe jashtë Qeverisë, që punojnë në Kosovë për implementimin e rezolutës 1325 ose çështjeve që lidhen ngushtësisht me të, siç janë promovimi i barazisë dhe lufta kundër dhunës me bazë gjinore. Në pjesën e dytë të kapitullit analizohen, politikat dhe programet që zbatohen në Kosovë, në funksion të paqes dhe sigurisë.

Në secilën prej këtyre fushave raporti synon t'u përgjigjet dy pyetjeve: cili është statusi i grave sot? Dhe, cilat janë problemet kyçe që kërkojnë ndërhyrje me politika dhe programe afatshkurtra dhe afatmesme?

Nga analiza e statistikave, studimeve dhe hulumtimeve është e qartë se është bërë përparim në mbledhjen e statistikave të ndara sipas gjinisë. Shumë institucione të Qeverisë po përgatisin gjithnjë e më shumë të dhëna të ndara sipas gjinisë, sidomos në fushat e dinamikës së popullsisë, të arsimit, punësimit dhe përfaqësimit publik në vendimarrje. Gradualisht statistikave gjinore po bëhen të disponueshme edhe në fusha të reja, përmes vërtetimeve dhe hulumtimeve, siç janë hendeqet gjinore të pagave, buxhetimi gjinor etj. Por, në të njëjtën kohë në disa sektorë të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe statistika gjinore, nuk janë mbledhur ende ose janë të pa-përditësuara, siç janë të dhënat mbi varfërinë, prekjen nga sëmundje si HIV AIDS, dhunën me bazë gjinore, viktimat civile të luftës, personat me aftësi të kufizuara etj.

Me gjithë përparimet e bëra në hulumtimet dhe studimet ku janë analizuar edhe treguesit gjinor, korpusi i studimeve që kërkohen për mbështetjen e kësaj analize me të dhëna, në këndvështrimin e Rezolutës 1325, nuk është i mjaftueshëm. Nevojiten të bëhen studime të thelluara për sektorë të veçantë siç janë: analiza mbi pjesëmarrjen e ulët të grave në forcat e sigurisë, vlerësimi sasior dhe cilësor i situatës së viktimave të luftës dhe nevojat e tyre për shërbime; qasja ndaj shërbimeve juridike, etj.

⁸ http://www.unwomen.org/wp-content/uploads/2011/10/UNSC-resolutions-on-women-peace-and-security_Poster_English.pdf

⁹ Vendimi i Qeverisë së Kosovës për Hartimin e planit të veprimit në zbatim të R 1325 i datës 20 Shkurt 2012.

¹⁰ Shiko Aneksi 1 "Lista e dokumentave të konsultuar"

II. ANALIZA E SITUATËS

II.1 Kosova dhe perspektiva e zhvillimit njerëzor

II.1.1 Veçoritë demografike dhe Indeksi i zhvillimit njerëzor në Kosovë

Sipas Indeksit të Zhvillimit Njerëzor (HDI) krijuar për të matur progresin njerëzor dhe mirëqenien e një kombi jo vetëm nga pikëpamja ekonomike, Kosova renditet si një ndër vendet me të ardhura të ulëta, me indeksin e zhvillimit njerëzor me vlerë 0.700¹¹. Ndarja gjinore përfaqëson një dominim të lehtë të meshkujve me 50,4% të popullsisë. Pjesa më e madhe e popullsisë¹² jeton në zonat rurale sipas një përpjesëtimi të vlerësuar 63:37. E vlerësuar si një nga perparësit e vendit popullsia e Kosovës është një popullsi e re, ku grupmosha 0-14 vjeç përfaqëson rreth 33% të popullsisë, ajo 15-64 vjeç rreth 61% të popullsisë. Është vlerësuar se 50% e popullsisë është nën 25 vjeç.

II.1.2 Gratë si faktor i ndryshimit

Ndryshimet ekonomike në Kosovë kanë qenë të dukshme dhe përfaqësohen me një seri reformash makroekonomike dhe integrimin në institucionet më të rëndësishme ekonomike dhe financiare siç janë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Rritja ekonomike për vitin 2011 vlerësohet në 5.5%¹³. Megjithatë, ekonomia është e dobët dhe varfëria një fenomen persistent, ku përrreth 17% të popullsisë vlerësohet që jeton në varfëri ekstreme¹⁴ me nën 0,93 Euro në ditë.

II.1.3 Përfaqësimi politik dhe pjesëmarrja e grave në vendimarrje

Në kuadrin e përpjekjeve vendore dhe ndërkombëtare që synojnë qeverisje gjithëpërfshirëse dhe demokratike, sigurimi i qasjes së grave në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet është thelbësor. Kosova renditet e para ndër vendet e rajonit për pjesëmarrjen e grave në nivelet më të larta të vendimarrjes. Është për t'u theksuar fakti që, Presidente e Republikës së Kosovës pas vitit 2011 është një grua. Gratë në Kosovë mbajnë 33.33% të ulëseve në Parlament, dhe 20-30% në Kuvendet Komunale. Kjo është arritur falë reformës zgjedhore dhe veçanërisht kuotës së pjesëmarrjes të përcaktuar prej 30%. Aktualisht 25% e kabinetit qeverisës drejtohet nga gratë. Në këtë drejtim mund të themi se kemi jo vetëm arritje sasiore por edhe cilësore, pasi 2 prej 3 zv/kryeministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë gra.

Kuvendi i Kosovës

Pas zgjedhjeve politike të vitit 2010, nga 120 anëtarë të Kuvendit të Kosovës 40 janë gra, ose 33.3% e tyre. Kështu, 14% janë zgjedhur me votë të drejtpërdrejtë dhe pjesa tjetër si rezultat e respektimit të kuotës gjinore.

¹¹ http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_countries_by_Human_Development_Index#Complete_list_of_countries

¹² Popullsia e Kosovës është vlerësuar 1,733,872 banorë sipas rezultateve preliminare CENSUS 2011

¹³ <http://www.gfmag.com/gdp-data-country-reports/240-kosovo-gdp-country-report.html#axzz1xIhtCoAa>

¹⁴ UNDP Human development report 2009

Por përfaqësimi i grave në Parlament nuk është reflektuar në fuqi efektive vendimmarrëse pasi si Kryesia e Parlamentit ashtu dhe pjesa më e madhe e Komisioneve Parlamentare kryesohen në pjesën më të madhe nga meshkujt. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës funksionojnë 13 komisione, 9 prej të cilave janë komisione funksionale. Një pjesë e mirë e tyre është e lidhur drejtpërsëdrejti me çështjen e grave, paqes dhe sigurisë. Kështu janë Komisioni i Punëve të Brendshme dhe Sigurisë; Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazisë gjinore, Personave të Humbur dhe Peticioneve. Kuvendi mund të ngrejë komisione “ad hoc” për çështje të veçanta.

Kryetari edhe të 5 nënkryetarët e Kuvendit të Kosovës janë meshkuj. Në krye të komisioneve parlamentare vetëm 2 ose 15% janë femra dhe 11 ose 85% meshkuj¹⁵. Nga ana tjetër politikën pro-gjinore të miratuar në Kuvend, janë të limituara dhe nuk i përgjigjen nevojave reale të grave për shërbime dhe pjesëmarrje, ndërsa legjislacioni i miratuar në një pjesë të konsiderueshme ka nevojë për plotësime¹⁶.

Gratë në pozicione drejtuese në Kuvendin e Kosovës

Komisionet parlamentare: Gratë drejtojnë dy prej 13 komisioneve parlamentare ose 15% të tyre. Këto janë komisioni për buxhet dhe finance si dhe Komisioni për të drejtat e njeriut, barazisë gjinore dhe personave të humbur dhe peticione.

Kryesia: Kryetari edhe të 5 nënkryetarët e Kuvendit të Kosovës janë meshkuj

Kuvendet Komunale

Kosova është e ndarë në 37 komuna. Pas zgjedhjeve të pushtetit vendor në Nëntor të 2009 dhe Qershorit 2010, 358 nga 1084 të zgjedhur ose **32.6%**¹⁷ janë gra.

II.1.4 Përfaqësimi i grave në ekzekutiv

Presidenca

Presidenti i Republikës së Kosovës është Kryetari i shtetit dhe sipas Kushtetutës përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës. Presidenti ka një mandat 5 vjeçar me të drejtë ri-zgjedhje.¹⁸ Gruaja e parë si presidente e Kosovës është zgjedhur nga Kuvendi me 7 Prill të 2011. Presidentja ka 9 këshilltarë, nga të cilët, 5 janë femra dhe 4 meshkuj.

Kabineti i Qeverisë së Kosovës

Qeveria merr vendime në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin, propozon projekt ligjet dhe amendimet e legjislacionit ekzistues. Gjithashtu mund të japë opinione për projekt-ligje të propozuara nga akterë të tjerë përveç Qeverisë.

¹⁵ Komisioni për buxhet dhe finance dhe Komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pa gjetur dhe peticione

¹⁶ OSBE 2012 Masat e zbatimit për legjislacionin që prek të drejtat e njeriut në Kosovë

¹⁷ See OSCE Municipal Profiles at <http://www.osce.org/kosovo/43753> and US State Department Background Note on Kosovo at <http://www.state.gov/r/pa/ei/bgn/100931.htm>.

¹⁸ See more information at the State Portal of the Republic of Kosovo, available at <https://www.rks-gov.net>

Gratë udhëheqëse në kabinetin Qeveritar .¹⁹

Kryeministri: Kryeministri i parë i Kosovës dhe kryetari i Qeverisë është zgjedhur me 9 Janar 2008.

Zëvendëskryeministrat: 2 prej 6 zëvendëskryeministrave janë gra, ose 33.3 % e tyre. Një prej tyre ka kryesuar Grupin Negociator me Serbinë dhe tjetra drejton Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Ministrat: 2 prej 19 ministrave të qeverisë së Kosovës janë gra, ose 10.5%. Përveç Ministrisë së tregtisë dhe industrisë, edhe Ministria e Integritimit Evropian udhëhiqet nga një grua.

Gratë në pozita drejtuese në nivel komunal

Në zgjedhjet e 2009 dhe 2010, për herë të parë elektorati votoi për të zgjedhur drejtpërsëdrejti kryetaret e komunave. Në këto zgjedhje të gjithë kryetaret ishin meshkuj dhe vetëm 9.4% e nën-kryetareve janë gra.²⁰

II.1.5 Partitë politike

Partitë politike kontribuojnë në formimin dhe shprehjen e vullnetit të popullit, dhe janë instrumenta themelore për pjesëmarrjen në politikë.

Gratë në pozicione drejtuese në partitë politike

Janë 8 parti politike (parlamentare) në Kosovë²¹. Gratë janë përfaqësuar në masën 10% në presidencat e partive politike, ndërsa vetëm një grua udhëheq një parti politike dhe një është zëvendës kryetare. Megjithatë, vetëm një grup parlamentar i partive pjesëmarrëse në kuvend udhëhiqet nga një grua.²²

Në përgjithësi gratë janë në pozicion inferior në partitë e tyre politike, krahasuar me meshkujt anëtarë të partive politike.

Vizibiliteti i grave kandidatë në media gjatë debateve politike dhe fushatave elektorale është shumë më i ulët se i meshkujve. Ndërsa perceptimi i publikut për pjesëmarrjen e grave në media është i ulët.²³

Artikujt ku gratë janë protagoniste zënë vetëm 10% të hapësirës, ndërsa artikujt ku të dyja gjinitë janë prezent – përbëjnë 25% të hapësirës²⁴

¹⁹ Informacion nga portali shtetëror i Republikës së Kosovës <https://www.rks-gov.net>

²⁰ Shiko OSBE Profili i komunave në <http://www.osce.org/kosovo/43753> dhe Departamenti i SHBA "Background Note on Kosovo at <http://www.state.gov/r/pa/ei/bgn/100931.htm>.

²¹ http://www.kipred.org/advCms/documents/57591_Fuqizimi%20i%20shtet%C3%ABsis%C3%AB%20s%C3%AB%20Kosov%C3%ABs%20n%C3%ABp%C3%ABmjet%20demokratizimit%20t%C3%AB%20partive%20politike%20-%20Alb.pdf

²² Në përgjithësi ka mungesa të dhënash për pjesëmarrjen e grave në partitë politike.

²³ Kosovo Country Program 2008-2011, p. 8.

²⁴ <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ-Hulumtimi%20Gratë%20në%20Mediat%20e%20Shkruara%20%202011-2012.pdf>

II.1.6 Administrata publike

Mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore janë krijuar në të gjitha nivelet e qeverisjes. Por megjithëse janë arritur kuota të mira në administratë publike, përsëri vendet udhëheqëse dominohen nga burrat. Nga statistikat zyrtare të MSHP/DASHC²⁵ del se shkalla e punësimit në administratë publike si në nivelin komunal ashtu edhe në atë qendror është në disfavor të grave. Edhe në sektorë me përqindje të lartë personeli gra, ato kanë kryesisht poste të ulëta dhe diferenca ndërmjet grave dhe burrave në pozita drejtuese dhe menaxheriale është e lartë në favor të burrave. Nëse krahasojmë shifrat e viteve 2009 deri në 2011, shikojmë se megjithëse kemi ecuri pozitive (një rritje të lehtë të punësimit të grave në administratën publike) përsëri ekziston një hendek ndërmjet kuotave që ka përcaktuar Ligji me ato që zbatohen në realitet. Sipas të dhënave në vitin 2011 është përfaqësimi më i lartë i grave në vendimmarrje që është 13.1%²⁶.

Gratë në administratën publike në nivel qendror dhe lokal				
Punësimi i grave në pozita drejtuese në administratën publike				
	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Progres/Regres
Burra	88.10 %	87.57 %	86.90%	0.67%
Gra	11.88 %	12.42 %	13.10%	
Punësimi i grave në pozicione menaxheriale				
	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Progres/Regres
Burra	77.93 %	77.39 %	74.33 %	3.9%
Gra	22.06 %	22.61 %	25.70 %	

Statistikat zyrtare të MSHP/DASHC tregojnë se tendenca e pjesëmarrjes së grave në pozicione drejtuese dhe menaxheriale është në rritje. Por me gjithë tendencën pozitive, gratë janë dukshëm më pak aktive në procesin e punës, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat²⁷. Megjithatë, legjislacioni në fuqi në Kosovë nuk përbën pengesë për përfshirjen e gruas në procesin e punës.

Në zonat rurale ka një nivel të ultë të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave në strukturat vendimmarrëse, sepse roli i grave në fshat është kryesisht i perceptuar rreth familjes dhe aktiviteteve të shtëpisë dhe mungon tërësisht inkurajimi dhe mbështetja nga familjet e tyre dhe komuniteti për t'u përfshirë në vendimmarrje.

II.1.7 Pjesëmarrja e grave në diplomaci

Roli i Shërbimit Diplomatik është të mbroje dhe promovojë interesat kombëtare në bote nëpërmjet rrugëve të ndryshme, dhe të kontribuojë për ruajtjen e paqes ndërmjet shteteve. Prej numrit total të stafit në shërbimin diplomatik (gjithsej 84), 17.8% janë gra. Rreth 20% e numrit total të ambasadoreve dhe konsujve (4 ambasadore dhe 3 konsuj), janë gra²⁸.

Gjykoj që ky rezultat jo i kënaqshëm vjen së pari si rezultat i vetëbesimit të ulët që kanë gratë për pozicione të tilla të rëndësishme. Kështu sipas të dhënave të MPJ në vitin 2010, për vendet e 18 ambasadorëve aplikuan 275 burra dhe vetëm 78 gra²⁹, ndërsa për vendet e shërbimit konsullor

²⁵ Te dhenat për K.K. Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan, Ranillugë, Kllokot dhe Graçanicë nuk janë përfshi në këtë Raport, në mungesë të sigurimit të tyre, nga komunat në fjalë

²⁶ Te dhenat për vitin 2012 ende nuk janë të gatshme nga ana e MSHP/DASHC

²⁷ Programi i Kosovës për Barazi Gjinore, http://stopvaw.org/uploads/kosovo_program_for_gender_equality

²⁸ Ministria e Punëve të Jashtme/ Departamenti për çështje ligjore, traktate dhe drejta të njeriut

²⁹ Islami -Kurti, Violeta; punimi MA, MPJ të dhëna viti 2010

aplikuan 415 burra, kundrejt 78 grave. Stafi i shërbimit diplomatik pas kryerjes së procedurave të rekrutimit numëron 52 persona, nga të cilët vetëm 9 janë gra.

Çështje kritike

- Megjithëse numri i grave në Diplomaci është duke u rritur ka akoma pengesa që duhen kapërcyer. Në diskutimet gjatë punës në grupe, GP erdhi në përfundimin se ka disa faktorë që i përjashtojnë gratë nga arena e politikës së jashtme dhe diplomacisë, siç janë:
 - Faktorët e ndikuar nga tradita dhe stereotipet gjinore
 - Normat kulturore praktikë diskriminuese gjatë procesit të rekrutimit Mungesa e masave të diskriminimit pozitiv, të cilat mbështesin dhe promovojnë gratë në karrierën e tyre diplomatike, duke i ndihmuar ato në kryerjen e detyrimeve familjare.

Progresi

- Kosova renditet e para në rajon për përfaqësim të grave në nivelet më të larta të vendim marrjes 33,33% e deputeteve janë gra. (vendet anëtarë të OSBEse duke përjashtuar vendet Nordike), ne të cilat pjesëmarrja e grave është 21.5%, ndërsa mesatarja në vendet Ballkanike është 24.6% (psh. Bosnja dhe Hercegovina 17.35, Kroacia 21.4%, Maqedonia 30.9%, Kosova 33.3%, Mali i Zi 12.3% dhe Serbia 32.4%).³⁰
- Kosova renditet e 17 ne bote për përfaqësimin e grave në vendim marrje 31

Hapsirat

- Një nga problemet që duhet nënvizuar është pjesëmarrja e grave në tregun e punës, e cila është shumë më e ulët se ajo e burrave.
- Gratë janë në nivele shumë të ulëta pjesëmarrëse në drejtimin e partive politike. Gjithashtu vendim marrja e tyre në Kuvend nuk ndikohet nga pjesëmarrja e lartë e tyre. E njëjta gjë ndodh në administratën publike ku vendim marrja i takon burrave, me gjithë pjesëmarrjen e lartë të grave dhe kushteve lehtësuese që i krijon ligji i shërbimit civil.
- Me gjithë progresin e bërë pjesëmarrja e grave në nivele drejtuese dhe manaxheriale mbetet shumë më e ulët se sa e përcakton neni 3 i Ligjit për Barazi Gjinore
- Përkundër shkollimit adekuat, femrat hasin në pengesa burokratike sidomos në procedurat e rekrutimit gjatë procesit të punësimit. Këto procedura ndikojnë drejtpërdrejt në sigurimin e një vendi të punës³².
- Gjatë fushatave elektorale hapsirat mediatike dhe debatet politike në media janë kryesisht domeni i burrave.

II.2.1 Pjesëmarrja e grave në sistemin gjyqësor

Nga të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës shihet se, nga 64 punonjës të punësuar në këtë institucion, 39% janë femra, kurse në pozita vendim marrëse, vetëm 16% janë femra. Siç ndodh edhe me institucionet e tjera, në nivele të larta të hierarkisë, numri i femrave vjen gjithnjë duke u zvogëluar. Është për t'u shënuar raporti gjinor në Gjykatën Supreme të Kosovës, në këtë Gjykatë

³⁰ See database of the Inter-Parliamentary Union – Women in Parliament, available at <http://www.ipu.org/wmn-e/world.htm>

³¹ ABGJ-Hulumtimi Gratë në Procesin e Punës dhe Vendim marrjes në Kosove 2011, faqe 5 .A

³² ABGJ-Gratë në Procesin e Punës dhe Vendim marrjes në Kosove- Konkluzione-2011

nga 11 gjyqtarë, 64% janë femra. Edhe në Gjykatën Ekonomike të Prishtinës është konstatuar një raport i ngjashëm gjinor, ku 67% gjyqtareve janë femra. Gjithashtu në gjykatat komunale të Kosovës, 75% janë femra. Një situatë të kundërt me këtë kemi te gjykatat komunale për kundërvajtje, në të cilat numri i femrave gjyqtare është dukshëm më i ulët, me vetëm 29%.³³

Në prokuroritë e niveleve të ndryshme gratë zënë 29% të vendeve.³⁴ Kjo prezencë ka ardhur duke u konsoliduar në vite. Në hulumtimin e vitit 2011 kjo shifër është rritur në 30%, krahasuar me vitin 2010.

	Viti 2010	Viti 2011	Progres/Regres
burra	59.31 %	59.88 %	0.57 %
gra	38.24 %	38.74 %	0.50 %

II.2.2 Perspektiva gjinore në sektorin e sigurisë

Gratë janë të përfaqësuara në numër të konsiderueshëm si punonjëse të institucioneve të ndryshme të sigurisë në Kosovë. Kështu rreth 32.5% e punonjësve civil të Ministrisë së FSK janë femra dhe në pozita vendimmarrëse janë 35%. Megjithatë, nqs i referohemi të dhënave për punonjës të uniformuar në Ministri vetëm 6.4 % e tyre janë femra. Më mirë paraqitet situata në FSK, ku numri i femrave të uniformuara është në masën 8.1%. Në sektorin e sigurisë vërehen ndryshime të ngadalshme por pozitive për sa i përket përfshirjes së çështjeve gjinore, madje kohët e fundit kemi një strategji për promovimin e grave. FSK-ja planifikon të ketë numrin prej 2500 pjesëtarë aktiv, nga ky numër femra synohet të jenë afërsisht 15%, ku deri më tani janë të punësuara rreth 5% nga numri i përgjithshëm i pjesëtarëve në FSK. Kjo përqindje përfaqësohet aktualisht në pozita vendimmarrëse.

Grate ne Policine e Kosovës
12.53% te oficerëve te policisë janë gra, ose 919 nga 7,331 e policeve oficerë. ¹
14.75% e stafit total te Policisë së Kosovës janë gra.
Afërsisht 10% e atyre qe shërbejnë në Policinë e Kosovës mbajnë grada te larta ushtarake (një gjeneral, një kolonel, një komandant brigade dhe një kryetar operacionesh).

Struktura gjinore në PK, në kategorinë e oficerëve të policisë është 12,53% femra dhe 87,47% meshkuj. Përveçse paraqet nivel jo të kënaqshëm, punësimi i femrave në këtë institucion ka probleme që lidhen me dorëheqjet e femrave nga PK. Kështu, nga numri i përgjithshëm i policeve femra, rreth 33.26% e kanë lënë punën, kundrejt 14% të meshkujve.³⁵ Hulumtimet kanë treguar se, ushtrimi i këtij profesioni nga gratë paraqet vështirësi të ndryshme, të cilat janë artikuluar nga vetë ato. Kështu 33 % e grave që kanë lënë punën në PK kanë pranuar se të ardhurat që sigurojnë gratë në këtë institucion janë të ulëta. Kjo tregon se niveli i pozicioneve që zënë gratë është gjithashtu i ulët. 20% e grave të dorëhequra kanë pranuar se institucioni nuk siguron kushte të përshtatshme pune për gratë. Puna me turne dhe shpesh larg zonës së banimit është arsyeja kryesore që gratë e reja dhe me fëmijë të vegjël heqin dorë nga puna në PK. Gjithashtu, mungesa e sigurimit të jetës, në kushtet kur puna në polici konsiderohet si punë me

³³ Norma, Hulumtimi dhe monitorimi i zbatimit të dispozitave të Ligjit për Barazi Gjinore,

³⁴ ESK- Gratë dhe burrat ne Kosove-2010

³⁵ Te dhënat e përmendura ne këtë seksion janë marre nga: Hulumtimi i bere nga vete PK

risk të lartë për jetën është një arsye më shumë për t'u dorëhequr. 9% e femrave që janë larguar nga PK pranojnë se në këtë institucion shanset për promovimin e tyre dhe ngritjen në detyrë janë të pakta. Gjithashtu 4% e grave që janë larguar me vullnetin e tyre nga detyra në PK, pranojnë se mjedisi në punë nuk është miqësor për femrat. Shpesh mungon respekti ndërmjet kolegëve, delegimi i detyrave ose nënvleftësimi i vlerave të grave. Për sa i përket pozitave drejtuese, njëri prej zv/drejtorëve të përgjithshëm të policisë është grua. 11.9% e stafit me grada të larta ushtarake janë gra.

Çështje kritike

- Pjesëmarrja e grave në forcat e sigurisë (FSK) është relativisht e ulët krahasuar standardin e NATO-s për 10-20%.
- Shënohen ritme të mira të pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse (35%) në forcat e sigurisë.
- Sektori i sigurisë vazhdon të perceptohet si domen i meshkujve
- Numri i grave të uniformuara në forcat e sigurisë (FSK) megjithëse është i ulët (8.1%) ka tendencë rritëse.
- Është shqetësues fakti që tendenca e punësimit të grave në PK ka ardhur duke u ulur si pasojë e dorëheqjeve.
- Numri i grave me grada të larta ushtarake në PK është 12.5%

II.2.3 Dhuna me baze gjinore

Ne kushtet aktuale të urbanizimit si gratë ashtu edhe burrat janë të ç'orientuar lidhur me rolet e tyre respektive. Shpërbërja e strukturës tradicionale të familjes po acaron edhe konfliktet brenda saj, e shprehur kjo me dhunën ndaj grave dhe vajzave. Studimet e bëra nga OJQ-të që punojnë në komunitet për adresimin e dhunës në familje, raportojnë se dhuna me bazë gjinore në Kosovë mund të atribuohet traditës dhe kulturës në marrëdhëniet familjare, por nga ana tjetër varfëria, papunësia, përdorimi i alkoolit, dhe thjesht pakënaqësia mund të jenë faktorët që ndikojnë në shprehjen në një shkallë kaq të lartë të dhunës në familje.

Mungesa e të dhënave periodike të unifikuara³⁶ mbi dhunën në familje, na detyron që të vazhdojmë t'i referohemi studimeve dhe rezultateve nga hulumtimet, e kryera, si bazë për të matur gravitetin e problemit të dhunës në familje dhe atë me bazë gjinore. Megjithatë konsultimi me këto studime e hulumtime na përfron me situatën reale të dhunës në familje në Kosovë.

Në prill të vitit 2008, Agjencia për Barazi Gjinore ndërmori iniciativën të hulumtojë çështjet e dhunës në familje në Kosovë, të cilin e realizoi Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RrGGK) me mbështetjen e UNDP, hulumtim i cili rezultoi me një raport "Siguria fillon në shtëpi". Gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë se:

- Në Kosovë dhuna në familje është një formë e dhunës me baze gjinore, që në pjesën dominuese të rasteve kryhet nga burrat ose partneret kundër grave dhe vajzave³⁷.

³⁶ Te dhënat e marra nga Njësia e dhunës familjare për rastet e raportuar në polici, MD, apo strehimoret, janë të dhëna të pamjaftueshme për të matur fenomenin, pasi ekziston e forte stigma e raportimit të dhunës (sipas hulumtimeve). Te gjithë biem dakord që dhuna raportohet në nivele shumë të ulëta.

³⁷ Siguria fillon në shtëpi- ABGJ - 2008- faqe 8, 20

- Më shumë se një e treta e të anketuarve besojnë se “është e natyrshme të ndodhi dhunë kur çifti grindet”³⁸.
 - Dhuna seksuale nuk njihet si dhunë familjare nëse ajo ndodh ndërmjet partnereve ³⁹
 - 82% e të anketuarve kanë pranuar se e konsiderojnë dhunën në familje një turp i cili nuk duhet të dalë jashtë shtëpisë⁴⁰
 - 40% e të anketuarve të cilët kanë përjetuar dhunë, kanë deklaruar se askujt nuk i kanë treguar për te ⁴¹.
 - Femrat që jetojnë në zonat rurale të varfra janë me të prira të përjetojnë dhunë.
 - Institucioni i cili është më i besueshëm për viktimat është Policia e Kosovës, që merr dhe denoncimet më të shumta të rasteve të dhunës.
 - Megjithatë nuk mund të jepen shifra të sakta, pranohet se programet kundër dhunës në familje i kushtojnë Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe tatimpagueseve disa qindra-mijëra Euro në vit. Nga të dhënat dhe perceptimet e mësipërme kuptojmë që dhuna në familje në Kosovë është një fenomen në përmasa relativisht të larta. Këtë gjë e mbështesin edhe studimet e vlerësimit që janë bërë nga disa organizata gjatë viteve 1995-2010⁴².
- Krahasimi i të dhënave të mbledhura nga studimet e bëra në Kosovë me ato të vendeve të tjera të rajonit, tregon qartë se rastet e dhunës në familje janë të nën-raportuara. Madje ato nuk raportohen as nga viktimat, pasi konsiderohet turp dhe një çështje që nuk duhet të dalë jashtë mureve të shtëpisë.

Raporti i monitorimit dhe të dhënat e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit⁴³ (Për periudhën 01.01.2011-31.12.2011) tregojnë se: janë ndihmuar 888 raste të reja të dhunës në familje. Nga të cilat :

- 739 raste janë dhune në familje
- 22 raste janë tentativa për dhunim
- 23 raste janë dhune ndaj fëmijëve
- 1 rast është braktisje e fëmijës
- 2 raste të incestit me fëmijë
- 25 raste abuzim seksual
- 38 raste trafikim me qenie njerëzore (+10 raste të supozuara)

Çështje kritike

- Dhuna në familje është një formë e dhunës me baze gjinore, që në pjesën dominuese të rasteve kryhet nga burrat ose partneret kundër grave dhe vajzave
- Krahasimi i të dhënave të mbledhura nga studimet, tregon se rastet e dhunës në familje janë të nën-raportuara.
- Përgjigja e mekanizmave ekzistuese për adresimin e dhunës në familje nuk është adekuate.

³⁸ Ibid, faqe 18

³⁹ Ibid, faqe 19

⁴⁰ Ibid, faqe 22

⁴¹ Ibid, faqe 27

⁴²

⁴² "Hulumtimi shpjegues mbi shkallën e dhunës mbi baza gjinore në Kosovë dhe ndikimi saj në shëndetin riprodhues" realizuar nga RrGGK në 2008

⁴³ Raport për vitin 2011 nga Koordinatorja e mbrojtjes së viktimave

II.2.4 Gratë viktime të dhunës seksuale gjatë luftës

Gjatë fushatës së dhunës së armatosur kundër popullsisë Kosovare, ndërmjet Mars-Qershor 1999, më shumë se 9000 burra, gra dhe fëmijë, pjesa më e madhe shqiptarë etnikë, janë vrarë nga forcat ushtarake serbe. Shumë të tjerë, janë marrë forcërisht nga shtëpitë e tyre dhe nuk janë kthyer me kurrë atje. Gratë dhe vajzat kanë qenë viktime të rrëmbimit, përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale. Në maj 1999, Komisionari i lartë për refugjatet (UNHCHR) vlerësim se numri i personave të dëbuar nga shtëpitë e trojet e tyre ishte 677.00044.

Dhuna seksuale është tabu për shoqërinë kosovare dhe shumë viktime nuk pranojnë të dokumentojnë rastin e tyre, si pasojë nuk ekzistojnë të dhëna të sakta mbi viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë⁴⁵. Megjithatë janë bërë përpjekje për grumbullimin dhe regjistrimin e një sërë dëshmish të dhunimeve të kryera gjatë luftës si nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, i cili funksionon në nivel qendror edhe në atë lokal, ashtu edhe nga Instituti për Krime të Luftës, i themeluar në nëntor të vitit 2011 nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë. Disa të dhëna të tjera janë siguruar nëpërmjet organizatave të cilat kanë ofruar shërbime të ndryshme për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës⁴⁶.

Gjithashtu ka përpjekje për identifikimin e rasteve dhe adresimin e problemeve psiko-sociale e shëndetësore të viktimave, por nuk ka një platformë të mirëfilltë institucionale e cila do të kishte identifikuar këto grupe të ndjeshme shoqërore dhe do t'i kishte njohur të drejtën e dëm-shpërblimit dhe shërbimeve adekuate sipas problemeve që kanë përjetuar viktimat si pasojë e dhunës.

Përkrah Gjykatës për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi (ICTY), edhe Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut, në partneritet me gjyqësorin e Kosovës, kishte në mandat ndjekjen e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit mes viteve 1999 dhe 2008. Në vitin 2007, nga një prokuror vendor është ngritur një kallëzim penal për krime lufte që përmbanin elemente të dhunës seksuale, por i dyshuari është liruar nga akuza.⁴⁷

Më 4 Qershor 2012, Grupi Punues Ndërmësor për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim, u themelua nën ombrellën e Zyrës së Kryeministrit për të trajtuar shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare gjatë luftës. Mandati i këtij grupi punues mbulon zbulimin e së vërtetës, reparacionet, drejtësinë dhe reformën institucionale dhe ka për qëllim realizimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, inkluzive dhe të ndjeshme gjinore për të adresuar të kaluarën në Kosovë, përmes miratimit të Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale.

Çështje kritike

1. Çështja e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë konfliktit, e qasjes së tyre në të drejta dhe e shpërblimeve të luftës është një çështje e anashkaluar, e cila duhet të rimerret me seriozitetin e duhur, sepse vetëm kështu do të ndihmohen këto shtresa të shoqërisë të tejkalojnë pasojat e saj.
2. Janë bërë disa përpjekje për identifikimin numrit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Megjithëse shifrat paraqiten konfuze, kjo nuk duhet të kufizojë mar rjen e masave dhe ngritjen e shërbimeve për rehabilitimin e viktimave.
3. Deri tani, institucionet nuk kanë arritur të hartojnë dhe implementojnë programe efektive në ndihmë të viktimave, përkrahja institucionale për të mbijetuarit vazhdon të jetë minimale apo fare inekzistente.

⁴⁴Amnesty International April 2012

⁴⁵ Shërimi i shpirtit - Shpërblimi i viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë Draft raporti për OHCHR (2013)

⁴⁶ Ibid- Tabela 6.-Incidenca e dhunës seksuale në Kosovë

⁴⁷ Nga viti 2008, Raporti i Amnesty International për Kosovën (Serbi): Sfidat për të përmirësuar një sistem të dështuar të drejtësisë së OKB-së, faqe 63.

III. VLERËSIMI I MEKANIZMAVE LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

III.1 Kuadri ligjor ekzistues dhe politikat

Analiza e mekanizmave ligjor do të respektojë parimin e hierarkisë së normave ligjore që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës. Kjo analize mbështetet në një seri analizash dhe studimesh që janë realizuar mbi zbatueshmërinë e Legjislacionit në Kosovë⁴⁸.

Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës kanë hartuar një kuadër ligjor dhe institucional të gjithanshëm në fushën e të drejtave të njeriut, dhe veçanërisht në atë të drejtave të grave, të cilat mishërohen në aktin ligjor më të lartë të Kosovës, në Kushtetutën e saj.

III.1.1 Dokumentet ligjore vendore që rregullojnë aspekte të ndryshme të Rezolutës 1325

Legjislacioni dhe politikat gjinore të Qeverisë së Republikës së Kosovës pasqyrojnë procesin e integritetit të saj në Bashkimin Evropian. Në këtë kuadër Kosova është përfshirë në harmonizimin e legjislacionit me *acquis communautaire*, trashëgiminë ligjore të Bashkimit Evropian. Barazia Gjinore është gjithashtu një prej objektivave dhe detyrave dhe pjesë përbërëse e Traktatit të KE-së dhe Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së. Progresi i Kosovës në fushat e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut monitorohet nga Raportet vjetore të Progresit për Kosovën të publikuar nga BE-ja

Kushtetuta e Republikës së Kosovës⁴⁹ garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe grave sipas standardëve ndërkombëtare dhe evropiane. Në nenin 7.2. është përcaktuar: “Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore”. Zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, garantohen me këtë Kushtetutë dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike⁵⁰.

Ligji Kundër Diskriminimit⁵¹ (LKD), ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2004. “Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, ngritja e shkallës së barazisë reale dhe realizimi i parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para Ligjit.” Qeveria është e obliguar që të ofrojë informata lidhur me Ligjin Kundër Diskriminimit ndërsa trajnime specifike janë ofruar për gjyqtarët dhe prokurorët mbi përdorimin praktik dhe konsistent të LKD-se. Ligji ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë dhe përcakton të gjitha format e paraqitjes së diskriminimit, siç janë: ngacmimi, viktimizimi dhe segregacioni. Është e rëndësishme të theksohet se fusha e zbatimit të këtij ligji mbulon jo vetëm institucionet publike, por edhe ato private, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet edhe të personave fizikë (Neni 4). Në procesin e zbatimit të Ligjit, ZKM-ja ka nxjerrë UA nr. 2006/04 për zbatimin e Ligjit kundër

⁴⁸

RrGGK “Raporti për monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325”; (OSBE) “Monitorimi i procesit të implementimit të ligjeve që prekin të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve në Kosovë” si dhe Norma “Hulumtimi dhe monitorimi i zbatimit të dispozitave të Ligjit për Barazi Gjinore”.

⁴⁹

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, http://assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf

⁵⁰

Neni 22, Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kapitulli 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Të Drejtat dhe Liritë Themelore) përcakton:

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.

3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme

⁵¹ Ligji Kundër Diskriminimit, Nr. 2004/3, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_3_al.pdf

diskriminimit. Ky UA synon të vendosë rregulla praktike; të krijojë lehtësira strukturore dhe fizike të domosdoshme për zbatimin e ligjit dhe për promovimin e trajtimit të barabartë.⁵²

Ligji për Barazinë Gjinore⁵³ ka hyrë në fuqi më 7 Qershor 2004. Me ane të këtij Ligji mbrohet, trajtohet dhe vendoset, barazia ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore. LBGJ përcakton standardet për arritjen e barazisë gjinore, dhe ndan përgjegjësitë për arritjen e kësaj barazie mes institucioneve, kuvendit, qeverisë dhe ministrive dhe komunave duke përfshirë edhe shoqërinë civile. Ligji përcakton një sërë masash ligjore për arritjen e barazisë së reale të femrave dhe meshkujve në shoqëri. I jep përparësi specifike asaj gjinie të cilës më herët nuk iu kanë takuar të drejta të barabarta me gjininë tjetër (Neni 2.9). Po ashtu, Ligji përcakton masën prej 40 përqind të pjesëmarrjes së njëres gjini në fushat e posaçme shoqërore, si kusht për arritjen e barazisë gjinore në përfaqësimin publik (Neni 2.12).

Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, është miratuar nga Kuvendi me 1 Korrik 2010. Ligji nënvizon masa të veçanta për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, krijimin e kushteve mbrojtëse të përshtatshme për viktimat, mbështetje dhe rehabilitim për to, dhe nga ana tjetër masa për dënimin e dhunuesëve. Ligji është hartuar pas një pune studimore të bërë nga Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me shoqërinë civile për identifikimin e hapësirave ligjore në Rregulloren e UNMIK si dhe sfidave dhe pengesave që ekzistojnë për implementimin e tij në praktike. Në ligj është rregulluar edhe mënyra e ndërveprimit dhe koordinimit të gjithë aktoreve përgjegjës për zbatimin e Ligjit⁵⁴

Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe familjeve të viktimave të luftës. I cili ka hyrë në fuqi në fund të vitit 2011. Qëllimi i këtij ligji është "përcaktimi i statusit dhe përkrahjes financiare për kategori të dala nga lufta përmes pensione dhe beneficioneve speciale." Kategori që përfitojnë nga ky ligj janë "viktimat civile, personat civilë të paaftësuar gjatë luftës dhe familjet e personave të marrë peng apo personave civilë që janë zhdukur gjatë luftës." Nuk përmenden specifikisht të mbijetuarit e dhunës seksuale apo torturës gjatë luftës si kategori e veçantë e viktimave civile apo të burgosurve të luftës (për rastet kur gratë janë marrë si pengje gjatë luftës). Si rrjedhojë grupet që përfitojnë nga shteti janë kryesisht veteranë të luftës dhe të burgosur politikë të gjinisë mashkullore apo familjet e dëshmorëve, ndërsa që neglizhohen të drejtat e të mbijetuarve të dhunës seksuale dhe torturës gjatë luftës, që kryesisht janë të gjinisë femërore.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës⁵⁵, është njëri ndër ligjet që nxit dhe siguron përfaqësimin gjinor në institucionet publike në Kosovë, duke përcaktuar kuotën prej

⁵² Shiko seksionin :Analiza e mekanizmave institucional"

⁵³ Ligji për Barazi Gjinore, Nr. 2004/2, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_2_al.pdf

⁵⁴ Security Begins at Home.

⁵⁵ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-073, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L073_al.pdf

30 përqind për përfaqësim gjinor në organet legjislativ si në nivel qendror dhe në atë lokal (Neni 111.6).

Ligji për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës⁵⁶ promovon parimin e barazisë gjinore (Neni 1.9), duke ofruar kushte dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje në Shërbimin Civil në institucionet e administratës qendrore dhe atyre komunale për të dy gjinitë, dhe ndalon çdo formë të diskriminimit (Neni 4). Megjithatë, për dallim nga sanksionimi i përfshirjes së komuniteteve në Shërbimin Civil, ku parashihet kuota prej 10 për qind (Neni 11), një kuotë e tillë nuk parashihet për barazi gjinore me këtë ligj.

Ligji për Policinë, miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 20 Shkurt 2008, bazohet ne parime të rëndësishme të cilat respektojnë barazinë gjinore dhe antidiskriminimin në përfshirjen e grave ne Forcat e policisë. Ligji përcakton gjithashtu masa për mbrojtjen e grave ne PK qe janë ne kushte specifike si dhe lehtësira që kanë të bëjnë me gjendjen e shtatzënisë ose pushimin e lehonisë. Gjithashtu ne ligj gjen shprehjen parimi i cili qartëson çështje që kanë të bëjnë me ngacmimet ne pune dhe rregullon procedurat e raportimit dhe përgjegjësitë e Komandës në këto raste.

Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, dhe Ligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë, janë miratuar nga Kuvendi me date 13 Mars 2008.

III.1.2 Politikat, strategjitë dhe planet e veprimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) (2008-2013). Në vitin 2008 Qeveria e Kosovës me Vendim Nr.07/17, 24.04.2008, ka miratuar Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2008-2013). Në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/18, të dt. 7.06. 2004, Qeveria e Kosovës ka përgjegjësinë për hartimin e PKBGJ-së, ndërsa ABGJ-ja në cilësinë e sekretarisë koordinuese ka udhëhequr procesin .

Me miratimin e PKBGJ-së Qeveria përmbushë obligimin nga Neni 4.4 i Ligjit për Barazi Gjinore, obligimet e dala nga PVPE respektivisht pika 39 (Të definoohen dhe të adaptohen programet e qeverisë për promovimin e të drejtave të gruas në Kosovë) dhe pika 116(Të zbatohet ligji për barazi gjinore. Të sigurohet mbizotërimi i të drejtave të gruas në të gjitha politikat dhe legjislacionin ekzistues)

Po ashtu vlen të theksohet se me këtë veprim Qeveria e RK-ës ka filluar me realizimin e objektivave të parapara në Synimet e Mileniumit –MDG të, Rezolutë kjo e nënshkruar nga Parlamenti i Kosovës, respektivisht veprimin e III të MDG – “Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave”.

PKBGJ është dokument strategjik që ka përcaktuar qëllimin, objektivat, politikat dhe aktorët kryesorë që janë përgjegjës për zbatimin e barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës sociale dhe ekonomike për femrat dhe meshkujt në Kosovë për periudhën 2008 -2013. Vlen të theksohet se PKBGJ përmban Planin e Veprimit me 8 objektiva strategjik si dhe koston buxhetore.

⁵⁶

Ligji për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149 <http://ks-gov.net/gazetazyrtare/Documents/Ligji%20per%20sherbimin%20civil%20%28shqip%29.pdf>

Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014. Programi u miratua me vendimin e Qeverisë NR 08/34, 25.08.2011.. Është programi i Qeverisë së Kosovës që përcakton objektivat strategjik dhe specifik kundër dhunës në familje dhe asaj me baze gjinore. Programi përcakton një plan masash të ndare në 3 shtylla dhe detajon aktivitetet, detyrat dhe përgjegjësitë për institucionet e Kosovës për të parandaluar dhe luftuar fenomenin, njëkohësisht për të integruar dhe rehabilituar viktimat e saj. Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar propozimin e ABGJ-se për emërim të Koordinatorit Nacional dhe themelimin e Grupit Koordinues për monitorimim e zbatimit të Planit të Veprimit të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje 2011-2014. -Grupi Koordinues është në përbërje të zv. Ministrave –dhe Koordinator Nacional për monitorimin e zbatimit të këtij plani të veprimit është emëruar Zv. Ministri i Drejtësisë.

Objektiv 1 i PKBGJ, “Përhapja e vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave dhe fuqizimin e gruas”, nderlidhet me:

1. **Objektivi 1 të PV R 1325,** “Pjesëmarrje e rritur e grave në vendim-marrje dhe në proceset e ndërtimit dhe ruajtjes së paqes- Rezultati 1.2- Janë hartuar politika afirmative dhe procedura për ngritjen e numrit të grave në shërbimin e jashtëm dhe në shërbimet e ndërtimit dhe ruajtjes së paqes të RKS.”
2. **Rezultati 2.3-** “Kapacitete të ngritura në strukturat e sigurisë për promovimin e grave si udhëheqëse dhe menaxhere si dhe ruajtja e numrit të grave në këto struktura”.
3. **Rezultati 3.4-** “Janë krijuar programet për fuqizimin ekonomik të viktimave të dhunës seksuale të lidhur me konflikt/luftë”.

Objektivi strategjik 3 i PKBGJ, “Përmirësimi i shëndetit të vajzave dhe grave duke rritur përgjigjen e sistemit shëndetësor ndaj nevojave shëndetësore të tyre” ndërlidhet me:

1. **Rezultati 3.3-** Është avancuar qasja në drejtësi e viktimave të krimeve seksuale të lidhura me konflikt/luftë, si dhe rehabilitimi i tyre psikosocial dhe mjekësor.

Objektivi strategjik 4 i PKBGJ, “Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave” ndërlidhet me:

1. **Rezultati 3.4-** “Janë krijuar programet për fuqizimin ekonomik të viktimave të dhunës seksuale të lidhur me konflikt/luftë”.

Objektivi strategjik 5 i PKBGJ, “Përmirësimi i situatës sociale të grave në rrezik, nëpërmjet rritjes së qasjes së tyre në shërbime sociale cilësore” ndërlidhet me:

1. **Rezultati 3.3-** Është avancuar qasja në drejtësi e viktimave të krimeve seksuale të lidhura me konflikt/luftë, si dhe rehabilitimi i tyre psikosocial dhe mjekësor.

Objektivi strategjik 8 i PKBGJ, “Të arrihet pjesëmarrje e barabartë e të dyja gjinive në vendimmarrje për të gjitha çështjet e rëndësishme në shoqëri” ndërlidhet me:

1. **Objektivi 1 të PV R 1325,** “Pjesëmarrje e rritur e grave në vendim-marrje dhe në proceset e ndërtimit dhe ruajtjes së paqes- **Rezultati 1.2-** Janë hartuar politika afirmative dhe procedura për ngritjen e numrit të grave në shërbimin e jashtëm dhe në shërbimet e ndërtimit dhe ruajtjes së paqes të RKS.”

Strategjia dhe PNV Antitrafikim (2011-2013). Në Korrik të 2008 Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore 2008-2011. Zëvendës Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme u paraqiti Koordinator Nacional për zbatimin e strategjisë dhe në përgjithësi për çështje të antitrafikimit. Në vitin 2011 pas vlerësimit të raporteve monitoruese të Strategjisë 2010-2011, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Strategjinë 2011-2013.

Me gjithë progresin e shënuar, para Policisë dhe MPB mbeten një numër sfidash, sidomos për sa i përket përmirësimit të mëtejme të kapacitetit të PK për luftimin e krimit të organizuar bazuar në konceptin e ‘policisë së udhëhequr nga intelijenca’, si dhe luajtjes së një roli më proaktiv

kundër krimit. Gjithashtu, mbetet një numër sfidash në kuadër të kapacitetit të brendshëm administrativ si dhe në drejtim të menaxhimit të procesit të vështirë të ristrukturimit. Problem shtesë për PK-në mbeten edhe rrethanat politike që pamundësojnë bashkëpunimin direkt me agjencitë ndërkombëtare pa u mbështetur në EULEX-in.⁵⁷

Plani i Veprimit për Fuqizimin Ekonomik të Grave, udhëzon implementimin e mëtejshëm të politikës zhvillimore gjinore dhe të grave, konventave, ligjeve dhe programeve. Brenda kontekstit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore në mënyrë specifike Plani i Veprimit është i dizajnuar të udhëheqë palët e interesuara që të:

- Shpejtojnë implementimin e progresit të Politikës për zhvillimin gjinor dhe të grave;
- Shpejtojnë implementimin e angazhimeve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave;
- Integrojnë çështjet gjinore në politika makro dhe sektorale;
- Lidhen me partnerët bashkëpunues dhe organizatat civile;
- Zgjerojnë koordinimin, llogaridhënien, monitorimin, vlerësimin dhe hulumtimin.

Plani i Veprimit për Antidiskriminim. Në tetor të vitit 2005, qeveria e Kosovës ka miratuar Planin Gjithëpërfshirës të Veprimit për zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit 2005–2007. Në dhjetor të vitit 2008, qeveria miratoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2009–2011, që ndër të tjera parashikon edhe hartimin e planit të ri të veprimit për zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit.

III.1.2 Dokumentet ligjore ndërkombëtare

Një sërë dokumentesh dhe konventash ndërkombëtare⁵⁸, përbëjnë bazën ligjore për hartimin e një legjislacioni adekuat

- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas CEDAW, dhe veçanërisht Rekomandimi i Përgjithshëm 19, kërkon në mënyrë eksplicite që shteti në pajtim me legjislacionin e vendit të marrë përgjegjësi për të parandaluar, hetuar dhe dënuar aktet e dhunës kundër grave, pa marrë parasysh se këto vepra janë kryer nga shteti ose shtetasit (Neni 9).
- Një akt tjetër ndërkombëtar i cili gjen zbatim në legjislacionin e Kosovës është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), e cila kërkon që shtetet të ndërmarrin masa efikase për të luftuar dhunën në familje.
- Platforma për Veprim e Pekinit në fushën e dhunës në familje, rekomandon rishikimin e legjislacionit dhe marrjen e masave të nevojshme për krijimin e mekanizmave të përshtatshëm për të siguruar mbrojtjen e të gjitha grave nga dhuna në familje e cila duhet të trajtohet si një vepër penale e dënueshme prej ligjit (neni 69).

Ndonëse Kosova nuk është vend anëtar i Bashkimit Evropian shumë shpejt do t'i kërkohej një sërë detyrimesh në drejtim të njohjes, harmonizimit të kuadrit ligjor dhe të strukturave të sistemit të drejtësisë me standardet e BE-se, siç janë:

- Dokumentet e të drejtave të njeriut të cilat referojnë parimet e traktateve të Kombeve të Bashkuara dhe të dokumentet e tjera sipas të cilëve dhuna kundër grave është një dhunë e të.

⁵⁷ Plani i veprimit për partneritet Evropian 2012

⁵⁸ Janë marrë nga puna përgatitore e bërë mars 2008, mësimet e nxjerra nga Plani 2005-2007.

drejtave themelore të njeriut. Si të tilla përmendim KEDNJ⁵⁹, Karta Sociale Evropiane, Konventa Evropiane për Ndalimin e Torturës dhe Trajtimit dhe ndëshkimit çnjerëzor ose degradues .

- Instrumentet e Bashkimit Evropian- nënshkrimi i MSA prodhon një sërë detyrimesh në drejtim të njo hjes, harmonizimit të kuadrit ligjor dhe të strukturave të sistemit të drejtësisë me këto standarde. BE ka trajtuar barazinë gjinore përmes një sërë direktivash, rezolutash, rekomandimesh dhe akteve, të nxjerra nga Këshilli Bashkimit i Evropian, Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian .

Çështje kritike

- Kosova ka një kornizë ligjore relativisht të mirë për të promovuar pjesëmarrjen e grave në jetën publike dhe mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës ndaj tyre.
- Pavarësisht nga prania e këtyre mekanizmave ligjore, përparimi në zbatimin e tyre ka qenë jo i rregullt dhe i ngadalshëm
- Shpesh mungojnë burimet (financiare, materiale dhe njerëzore) për zbatimin e këtyre ligjeve dhe akteve nen-ligjore
- Ratifikimi i konventave ndërkombëtare nuk shoqërohet me masa të tjera për plotësimin e legjislationit vendas.
- Ka disa ligje të cilat mungojnë në kuadrin kombëtar të legjislacionit, siç është “Ligji i punës” Ligji mbi sigurimet shëndetësore etj
- Si programe dhe strategji ndërsektoriale, të gjitha strategjitë, programet dhe planet e veprimit kanë rrjedhoja për një sërë institucioneve. Sfidat për realizimin e tyre qëndron tek koordinimin dhe bashkërendimi i institucioneve. Analizat tregojnë se shpesh këto plane nuk realizohen për shkak të mungesës së koordinimit ndërinstitucional.
- Monitorimi i Planeve të Veprimit shpesh mbetet në letër. Shumë pak shikojmë reflektim dhe reagim mbi raportet e monitorimit, për masat dhe veprimet e përealizuara.

⁵⁹Shiko Aneksin “Aktet ligjore”

III.2 Mekanizmat institucional

Në Kosovë ekzistojnë një sërë institucionesh publike, private dhe të shoqërisë civile, misioni i të cilave është promovimi i çështjes gjinore, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe fuqizimi i grave. Për efekt të kësaj analize ne do të përqendrohemi në Institucionet në nivel qendror, pasi detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të varësisë rrjedhin nga detyrat e institucioneve qendrore.

III.2.1 Institucionet vendore

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Sipas dispozitave kushtetuese, Kuvendi është institucioni ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli⁶⁰. Neni 71.2. i Kushtetutës përcakton se “Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektojë parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranueshme në pajtim me parimet ndërkombëtare⁶¹. Kuvendi, mund të caktojë komisione për çështje të veçanta. Janë dy Komisione të Kuvendit të Republikës së Kosovës të cilët duhet të promovojnë dhe të ndihmojnë në zbatimin Rezolutës 1325. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, dhe Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri. Komisioni për punë të brendshme dhe siguri, ka përgjegjësi në angazhimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e politikave dhe strategjive për sigurinë e brendshme. Po ashtu, ky Komision ka përgjegjësi për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e implementimit të standardeve të sigurisë, iniciimin e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale, mbikëqyrë menaxhimin dhe dhënien e dokumentacionit personal dhe të dokumentacionit të udhëtimit si dhe monitoron bashkëpunimin rajonal në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Këshilli i Sigurisë së Republikës së Kosovës. Sipas dispozitave Kushtetuese, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë, përgatit strategjinë e sigurisë për Republikën e Kosovës. Ligji përcakton “Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës” si dhe misionin e tij⁶².

Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Ligji për Barazi Gjinore në Nenin 4.7 përcakton se “Detyrë dhe përgjegjësi e qeverisë dhe ministrive në fushën e barazisë gjinore është edhe promovimi dhe garantimi i të drejtave të barabarta gjinore”.

Agjencia për Barazi Gjinore - Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim Nr. 5/131 të datës 1 shkurt 2005 ka themeluar Zyrën për Barazi Gjinore si organ të veçantë të Qeverisë së Kosovës konform nenit 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2004/18, të datës 7 qershor 2004, mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji Nr. 2004/2).

Me Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 03/2006 të datës 12.07.06 Zyra për Barazi Gjinore prej 1 Shtatorit 2006 shndërrohet në Agjenci për Barazi Gjinore, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Agjencia për Barazi Gjinore ka mandat të zbatojë dhe të monitorojë zbatimin e Ligjit për Barazi

⁶⁰ Funksioni i Kuvendit rregullohet me Kapitullin IV (Kuvendi i Republikës së Kosovës) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

⁶¹ Neni 71 (Kualifikimet dhe Barazia Gjinore) -Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

⁶² Neni 127 (Këshilli i Sigurisë së Kosovës), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, KSK ka rol këshillues në të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e Kosovës dhe kontributin e tij për stabilitetin rajonal, rekomandon politika dhe strategji për sigurinë dhe duhet të ofrojë informata dhe vlerësime të gjendjes së sigurisë në Kosovë, që t'i mundësojnë Qeverisë së Republikës së Kosovës marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me çështjet e sigurisë

Gjinore duke promovuar vlerat dhe mundësitë e barabarta pa marrë parasysh përkatësinë gjinore. Platforma e punës : Programi i Kosovës për barazi gjinore i miratuar Qeveria e RK-ës me vendimin Nr. 7/17 të dt. 24.04.2008 . Vendimi obligon institucionet e Republikës së Kosovës për zbatimin e tij. Agjencia është përgjegjëse për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës politike, ekonomike, sociale dhe kulturore si faktor i rëndësishëm i funksionimit të institucioneve demokratike. Ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Barazi Gjinore, ABGJ gjatë kryerjes së detyrave të saj lidhur me çështjet gjinore i bashkërendon aktivitetet e saj me Zyrtaret për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna.

Zyrtaret për Barazi Gjinore. Janë emëruar në të gjitha ministritë dhe komunat. Ato janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve për promovimin e barazisë gjinore dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore dhe politikave strategjike për barazi gjinore si PKBGJ, Programi Kundër dhunës në familje, Plani i Veprimit për fuqizimin ekonomik etj.

Këshilli Ndërmnistror për Barazi Gjinore. Ne nenin 4.9. të LBGJ-së përcaktohet se Qeveria formon Këshillin ndërmnistror, anëtarë të të cilit janë Zyrtarët për Barazi Gjinore të ministrive. Me vendim nr.05/157 të Qeverisë së Kosovës aprovohet Rregullorja nr.01/2006 për Themelimin Kompetencat dhe Detyrat e Këshillit Ndërmnistror për Barazi Gjinore. Me këtë rregullore përcaktohen kompetencat dhe Detyrat e Këshillit Ndërmnistror për Barazi Gjinore. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Barazi Gjinore udhëheq Këshillin me qëllim koordinimin e aktiviteteve dhe bashkërenditjes në fushën e barazisë gjinore.

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK). Sipas dispozitave kushtetuese, Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës, dhe mund të dërgojë pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare⁶³. Duke marrë parasysh që Rezoluta 1325 thekson rëndësinë e përfshirjes së perspektivës gjinore në operacionet paqeruajtëse dhe të ndërtimit të paqes, duhet pasur parasysh edhe kërkesën që vendos Rezoluta 1325 që personeli ushtarak dhe civil që do të dërgohet në këto misione të jetë i trajnuar mbi këto çështje nga vetë shtetet anëtare.

Policia e Kosovës është themeluar me Ligjin nr. 03/I-035, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si shërbim publik në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë të Punëve të Brendshme (MPB) dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të përgjithshëm të Policisë, i cili është emëruar nga Kryeministri. Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Nenin 132, përcakton se Avokati i Popullit është një Institucion i pavarur, në nivel kushtetues, i cili ka kompetencat si me poshtë:

1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.
2. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

⁶³Neni 126 (Forca e Sigurisë e Kosovës)- Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit që nga viti 2004, kur edhe ka hyrë në fuqi Ligji për Barazi Gjinore, ka krijuar Njesinë për Barazi Gjinore, e cila ka mandat që të trajtojë të gjitha ankesat/rastet e shkeljes së rregullave të barazisë gjinore kundër individëve apo grupeve të individëve të cilat janë kryer nga autoritet publike

